

KREU VI
INFORMIMI DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT
PËR APLIKIMIN PËR LEJE MJEDISI TË TIPIT A
DHE B

1. Kërkuesi, përpara aplikimit në QKL, dërgon në AKM, në njësinë e qeverisjes vendore (NJQV) dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit (ARM) ku do të ketë vendndodhjen instalimi një njoftim, me shkrim dhe në formë elektronike (CD, DVD), për aplikimin që do të kryejë për t'u pajisur me leje mjedisore të tipit A ose B, në të paktën 20 kopje elektronike për secilin institucion.

2. Njoftimi duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".

b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;

c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;

ç) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;

d) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;

dh) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkuftar, kur kërkohet procedura e VNM-së;

e) Konsultimet ndërkuftare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;

ë) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;

f) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

3. AKM-ja publikon, në faqen e saj të internetit, njoftimin sipas pikës 2 të këtij kreu, për të paktën 20 (njëzet) ditë kalendrike, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit.

4. Pas publikimit të njoftimit në faqen e internetit të AKM-së, kërkuesi publikon në, të paktën, një gazetë të zonës ku do të ushtrohet veprimtaria dhe në një gazetë kombëtare njoftimin për aplikimin, duke iu referuar për informacion më të hollësishëm faqes së internetit të AKM-së. Njoftimi publikohet në, të paktën, dy numra të njëpasnjëshëm të secilës gazetë.

5. Njoftimi në gazetë duhet të përmbajë, të paktën:

a) llojin e instalimit/veprimtarisë;

b) emrin e personit fizik/juridik;

c) adresën e vendndodhjes së instalimit;

ç) adresën e internetit ku është publikuar njoftimi dhe adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit.

6. NJQV-ja (bashkia apo komuna), në territorin e së cilës do të jetë vendndodhja e instalimit, pasi merr njoftimin sipas pikës 2, të këtij kreu, e publikon në një vend të dukshëm në mjediset e saj për të paktën 20 (njëzet) ditë.

7. Publiku ka të drejtë të konsultojë në mjediset e NJQV/AKM/ARM dhe të kërkojë një kopje të njoftimit, sipas pikës 2, të këtij kreu, nga NJQV/AKM/ARM, pa pagesë.

8. Publiku mund të bëjë komente, me shkrim ose në mënyrë elektronike, mbi njoftimin për leje mjedisi të tipit A në adresën e AKM-së brenda afatit 20-ditor

9. Në përfundim të afatit 20-ditor, kërkuesi, në bashkëpunim me AKM-në dhe NJQV-në, brenda 25 (njëzet e pesë) ditëve organizon një dëgjese me publikun dhe palët e interesuara, përfshirë OJF-të.

10. Njoftimi për dëgjuesën me publikun shpallet gjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve:

- a) në radio ose TV dhe gazetën vendore;
- b) në faqen e internetit të AKM-së dhe NJQV-së;
- c) në tabelën e njoftimeve, në një vend të dukshëm në mjediset e NJQV-së dhe ARM-së së qarkut përkatës.

11. Njoftimi duhet të shoqërohet me:

- a) llojin e instalimit/veprimtarisë;
- b) emrin e personit fizik/juridik;
- c) adresën e vendndodhjes së instalimit;
- ç) vendin ku gjendet kopja e njoftimit në NJQV-në dhe adresën elektronike të AKM-së ku është publikuar njoftimi.
- dh) përcaktimin e vendit, të datës dhe orës së organizimit të dëgjuesës me publikun.

12. Procesverbali i dëgjuesës mbahet nga kërkuesi dhe nënshkruhet nga pjesëmarrësit në dëgjuesë. Kopje të procesverbalit u vihen në dispozicion publikut, palëve pjesëmarrës në dëgjuesë, NJQV-së dhe AKM-së.

13. Kërkuesi, kur aplikon për leje mjedisi të tipi A dhe të tipit B, harton një relacion rreth dëgjuesës me publikun dhe palët e interesuara dhe e dorëzon në QKL.

14. Shpenzimet e organizimit të dëgjuesës mbulohen nga kërkuesi.

15. AKM-ja, gjatë hartimit të aktit të miratimit të lejes së mjedisit të tipit A dhe B, merr parasysh çdo koment, informacion, analizë apo mendim të paraqitur nga publiku që vlerësohet i vlefshëm dhe argumenton arsyet kur ato nuk janë marrë parasysh.

16. AKM-ja, kur e gjykon të arsyeshme, delegon ARM-në e qarkut përkatës për të marrë pjesë në dëgjuesën me publikun